



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr.16/2018

Rregulla dhe metodologjia për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë

Korrik, 2018



Përmbajtja

KREU I - RREGULLA PËR PËRGATITJEN E BILANCEVE TË ENERGJISË.....	4
1 QËLLIMI	4
2 PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET.....	5
3 BAZA LIGJORE.....	6
4 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA	7
5 BILANCET E ENERGJISË	8
5.1 BILANCET E ENERGJISË ELEKTRIKE.....	8
5.2 BILANCET E ENERGJISË TERMIKE.....	9
6 PYETËSORËT	10
KREU II - METODOLOGJIA PËR PËRGATITJEN E BILANCEVE TË ENERGJISË.....	13
7 PËRGATITJA E BILANCEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE	14
<i>Parashikimi i kërkesës për energji elektrike.....</i>	14
<i>Shpenzimet vetanake në termocentrale</i>	14
7.1 BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	16
7.1.1 <i>Përmbajtja e Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike.....</i>	16
7.1.2 <i>Saldo e bilancit të energjisë.....</i>	17
7.1.3 <i>Afatet kohore të bilancit vjetor të energjisë elektrike.....</i>	20
7.2 RISHIKIMI I BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE.....	21
7.3 BILANCI AFATGJATË (10 VJEÇAR) I ENERGJISË ELEKTRIKE	21
7.3.1 <i>Projeksionet e zhvillimit ekonomik.....</i>	21
7.3.2 <i>Parashikimi i kërkesës dhe humbjeve</i>	21
7.3.3 <i>Parashikimi i prodhimit</i>	22
7.3.4 <i>Emetimet e ndotësve të ajrit</i>	22
7.3.5 <i>Përmbajtja e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike.....</i>	22
7.3.6 <i>Afatet kohore të Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike.....</i>	24
7.4 PLANI I ADEKUACISË SË GJENERIMIT	25
8 PËRGATITJA E BILANCEVE TË ENERGJISË TERMIKE	26
8.1 TË DHËNAT E NEVOJSHME PËR BILANCET E ENERGJISË TERMIKE	26
8.1.1 <i>Parashikimi i kërkesës për Energji Termike.....</i>	26
8.2 BILANCI VJETOR I ENERGJISË TERMIKE.....	27
8.2.1 <i>Përmbajtja e bilancit vjetor të energjisë termike.....</i>	27
8.2.2 <i>Afatet kohore të Bilancit Vjetor të Energjisë Termike.....</i>	28
8.3 BILANCI AFATGJATË I ENERGJISË TERMIKE.....	30
8.3.1 <i>Projeksionet e zhvillimit ekonomik.....</i>	30
8.3.2 <i>Parashikimi i Kërkesës dhe humbjeve.....</i>	30
8.3.3 <i>Parashikimi i prodhimit të energjisë termike.....</i>	30
8.3.4 <i>Parashikimi i emetimeve të ndotësve.....</i>	31
8.3.5 <i>Përmbajtja e dokumentit.....</i>	31
8.3.6 <i>Afatet kohore të Bilancit Afatgjatë të Energjisë Termike.....</i>	33
KREU III - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	35
9 DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME.....	35
9.1 GJUHA ZYRTARE	35



9.2	INTERPRETIMI	35
9.3	PLOTËSIM-NDRYSHIMET E RREGULLËS DHE METODOLOGJISË	35
9.4	HYRJA NË FUQI	35
KREU IV - SHTOJCAT		36
10	SHTOJCA PËR BILANCET E ENERGJISË ELEKTRIKE.....	36
10.1	SHTOJCA A - ORARET KOHORE PËR BILANCET E ENERGJISË ELEKTRIKE	37
10.2	SHTOJCA B - PYETËSORI PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK	38
10.3	SHTOJCA C - PYETËSORËT PËR BILANCIN VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE	39
10.4	SHTOJCA D - PYETËSORËT PËR BILANCIN AFATGJATË TË ENERGJISË ELEKTRIKE.....	47
11	SHTOJCAT PER BILANCET E ENERGJISË TERMIKE	55
11.1	SHTOJCA E - ORARET KOHORE PËR BILANCET E ENERGJISË TERMIKE	55
11.2	SHTOJCA F - PYETËSORI PËR KAPACITETET E REJA TË ENERGJISË TERMIKE.....	56
11.3	SHTOJCA G - PYETËSORËT PËR BILANCIN VJETORË TË ENERGJISË TERMIKE	58
11.4	SHTOJCA H - PYETËSORËT PËR BILANCIN AFATGJATË TË ENERGJISË TERMIKE	64



KREU I - RREGULLA PËR PËRGATITJEN E BILANCEVE TË ENERGJISË

1 QËLLIMI

Qëllimi i përgatitjes së këtij dokumenti është që të përcaktojë parimet, procedurat dhe metodologjitë për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Elektrike dhe Energjisë Termike. Sipas ligjit për energji kërkohet që të trajtohet edhe bilanci i gazit natyror, por meqë nuk ka sistem të gazit ende në Kosovë, gazi natyror nuk trajtohet në këtë dokument¹.

Me anë të këtij dokumenti sigurohet që operatorët që veprojnë në sektorin e energjisë të paraqesin sipas afatit kohor të paraparë planet e tyre të prodhimit, konsumit dhe humbjeve, për të mundësuar operimin sa më efikas të sistemeve përkatëse të energjisë. Këto informata janë të domosdoshme në mënyrë që operatorët të planifikojnë orarin e tyre të investimeve kapitale, revizioneve dhe planin e riparimeve dhe të mirëmbajtjes, si dhe planifikimet e importit dhe eksportit nga operatorët përkatës.

¹ Regulla do të amandamentohet për përfshirjen e gazit natyror, në kohën kur do të zhvillohet rrjeti i gazit natyror në Kosovë.

2 PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sipas përkufizimit në Nenin 3 paragrafi 1.37 të Ligjit për Energjinë, (ligji nr. 05/L-081).
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Energjisë Elektrike.
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji, sipas përkufizimit në Nenin 3, paragrafi 1.58 të Ligjit për Energjinë, (ligji nr. 05/L-081)
GAP	Plani i Adekuacisë së Gjenerimit, sipas përkufizimit në Kodin e Rrjetit (Kodi i Planifikimit, Neni 9.2)
Ministria	Ministria përgjegjëse për Energji (aktualisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik- MZHE).
PZhT	Plani Zhvillimor i Transmetimit – dokument i publikuar çdo vit nga OST-i, në bazë të kërkesave të nenit 10 të Ligjit për Energjinë, (ligji nr. 05/L-081) dhe sipas përkufizimeve në Kodin e Rrjetit (Neni 5 i Kodit të Planifikimit).
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit, sipas përkufizimit në Nenin 3 paragrafi 1.38 të Ligjit për Energjinë, (ligji nr. 05/L-081).
BPV	Bruto prodhimi vjetor

3 BAZA LIGJORE

Në bazë të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081, parashikimi i kërkesave për energji elektrike, gaz natyror dhe energji termike, mënyra dhe masat e plotësimit të saj përcaktohen në Bilancin Vjetor të Energjisë dhe në Bilancin Afatgjatë të Energjisë që miratohen dhe publikohen nga Rregullatori.

Në Nenin 8 të Ligjit për Energjinë, paragrafi 2 theksohet se: *Metodologjia, rregullat dhe procedurat e përgatitjes dhe miratimit të Bilancit Vjetor dhe Bilancit Afatgjatë të Energjisë përcaktohen me rregullore të veçantë që hartohet dhe miratohet nga Rregullatori.*

Ndërsa në paragrafin 3 thuhet: *Në rregulloren e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni rregullohen çështjet lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e operatorëve në përgatitjen e bilanceve të energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë termike, detyrimet e palëve të përfshira për furnizimin me të dhëna për operatorët përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të bilanceve, përmbajtjen e të dhënave, afatet kohore të dorëzimit të të dhënave dhe procedurat e dorëzimit dhe miratimit.*

Duke u bazuar në këto kërkesa nga ligji për energjinë si dhe detyrat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të përcaktuara në ligjin për Rregullatorin e Energjisë lidhur me *hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore*, është përpiluar kjo rregull që përmban edhe metodologjinë e zhvillimit të Bilanceve të Energjisë. Në këtë dokument janë të përshkruar llojet e bilanceve, kërkesat për të dhënat që duhet të përmbajnë, afatet kohore si dhe procedurat për hartimin dhe miratimin e tyre.

Në bazë të Ligjit për Energjinë kërkohen të përgatiten tri dokumente të ndryshme:

- **Bilanci Vjetor i Energjisë për vitin paraprak** - përgatitet, miratohet dhe publikohet nga Agjencia përgjegjëse për statistika zyrtare. Ky dokument duhet të përgatitet çdo vit.
- **Bilancet Vjetore të Energjisë** - zhvillohen nga operatori i sistemit të transmetimit (për energji elektrike) dhe nga operatorët e sistemeve të shpërndarjes së energjisë termike (për energji termike) dhe pas marrjes së mendimit nga Ministria, dërgohen për miratim te Rregullatori. Këto dokumente duhet të përgatiten çdo vit.
- **Bilancet Afatgjata të Energjisë** - përfshijnë parashikimin për një periudhë dhjetë (10) vjeçare dhe zhvillohen nga operatori i sistemit të transmetimit (për energji elektrike) dhe nga operatorët e sistemeve të shpërndarjes së energjisë termike (për energji termike) dhe pas marrjes së mendimit nga Ministria, dërgohen për miratim te Rregullatori. Azhurnimet e Bilancit Afatgjatë miratohen çdo dy (2) vjet.

OST dhe OSSH-të duhet të konsultohen me Zyrën e Rregullatorit për Energji, sa i përket planifikimit të parashikimeve të nevojshme të Bilanceve të Energjisë.

Në bazë të Ligjit për Energjinë, Rregullatori pas miratimit të Bilanceve veç e veç, i përgatit dhe publikon ato në një dokument unik më së voni deri më pesëmbëdhjetë (15) dhjetor të vitit aktual që i paraprinë periudhës vijuese.

4 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA

Me qëllim të përgatitjes së bilanceve të energjisë, nga institucionet përfshirë ministrinë përkatëse, kërkohet bashkëpunim për ofrimin e të dhënave:

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik**
Ofron të dhëna dhe informata relevante, si dhe komenton dhe jep mendimin e saj në lidhje me përputhjen e dokumenteve të bilanceve me strategjinë e energjisë dhe programeve të zbatimit të saj.
- **Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Agjensioni Pyjor i Kosovës**
Ofron të dhëna për biomasë, biokarburante dhe mbetjet bujqësore që përdoren si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike.
- **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit**
Ofron të dhëna për emetimin e ndotësve kryesorë (CO₂, SO₂, NO_x, Pluhur dhe të tjera) dhe faktorët konvertues të tyre për të gjitha lëndët djegëse.
- **Agjencia e Statistikave të Kosovës**
Ofron të dhëna për Bruto Produktin Vendor (BPV), pjesëmarrjen e BPV në sektorët e ekonomisë (amvisëri, industri, shërbime dhe bujqësi), për numrin e banorëve, numrin e amvisërive, të dhëna për statistikave energjetike që janë në kompetencë të saj dhe të dhëna tjera relevante.
- **Ndërmarrjet e energjisë elektrike**
Ofron të dhëna për prodhimin bruto dhe neto të energjisë elektrike (sipas llojit të karburantit të shfrytëzuar), kapacitetin e instaluar të centraleve, importin dhe eksportin, energjinë elektrike të furnizuar, humbjet në transmetim dhe shpërndarje, të dhëna lidhur me nënstacionet, të dhëna lidhur me gjatësinë dhe nivelin e tensionit të linjave, linjat e reja dhe të planifikuara si dhe të dhëna tjera relevante.
- **Ndërmarrjet e Energjisë Termike**
Mbledhin dhe përgatisin të dhëna energjetike për prodhimin bruto dhe neto të energjisë termike, konsumin vetanak, humbjet e energjisë termike në shpërndarje, kapacitetet e instaluara dhe operative, konsumin e energjisë termike, konsumin e lëndëve djegëse në ngrohtore, numrin e nënstacioneve, të dhëna lidhur me gjatësinë e rrjetit, linjat e reja dhe të planifikuara si dhe të dhëna tjera relevante.
- **Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)**
Ofron të dhëna për shfrytëzimin e resurseve minerale energjetike, të dhëna gjeografike, gjeologjike.
- **Komunat**
Ofron të dhëna për kërkesat për energji sipas planeve komunale të zhvillimit, si dhe të dhëna tjera relevante.

5 BILANCET E ENERGJISË

Bilancet e energjisë duhet të përmbajnë të dhëna dhe informata të nevojshme për të siguruar funksionim të rregullt të sektorit energjetik. Të dhënat e paraqitura në bilance, kryesisht të dhënat e bilanceve afatgjata duhet të jenë në përputhje edhe me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës.

Në bazë të këtyre të dhënave bëhet edhe parashikimi i nevojave për investime në sistemin energjetik për të garantuar sigurinë e furnizimit për konsumatorët.

Bilancet e Energjisë Elektrike dhe Energjisë Termike mund të përfshijnë informacione që për nga natyra janë konfidenciale apo të ndjeshme. Shembuj të informatave të tilla janë planet për të zgjeruar dhe zvogëluar (apo mbyllur) kapacitetet e mëdha të prodhimit apo konsumit. Edhe planet për kapacitete të reja gjeneruese gjithashtu mund të konsiderohen të ndjeshme. Gjatë përgatitjes së Bilancit Vjetorë dhe Afatgjatë të Energjisë, OST-ja dhe OSSH-të do t'i shënojnë me 'konfidenciale' të gjitha të dhënat të cilat atyre i janë dhënë në mënyrë konfidenciale.

Në vijim janë paraqitur të dhënat e nevojshme dhe udhëzimet për përgatitjen e bilanceve vjetore dhe afatgjate të energjisë elektrike dhe energjisë termike.

Për përgatitjen e Bilancit Vjetorë dhe Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Termike, të dhënat duhet të grumbullohen nga Kompanitë e gjenerimit, OST, OSSH-të, Furnizuesit, Konsumatorët e kyçur në nivelin 110 kV e më lartë (për energji elektrike).

Komponentët e detyrueshme të bilanceve vjetore të energjisë janë:

- *parashikimi i kërkesës për çdo muaj të vitit vijues;*
- *parashikimi i furnizimit për plotësimin e kërkesës;*
- *parashikimi i konsumit të lëndëve të para të energjisë, nivelet e rezervave dhe kapacitetet rezervë;*
- *niveli vjetor i kapacitetit rezervë (kufiri i rezervës) i centraleve të energjisë dhe pajisjeve;*
- *nivelet e duhura të rezervave operative çdo vit dhe kriteret lidhur me efikasitetin e energjisë për çdo vit.*

Komponentët e detyrueshëm të bilanceve afatgjata janë:

- *parashikimi i kërkesave;*
- *parashikimi i furnizimit për mbulimin e kërkesave;*
- *mënyra për përmbushjen e kërkesave;*
- *një listë të niveleve të nevojshme të deponimit dhe kapacitetit rezervë të nevojshëm për sigurimin e shkallës së planifikuar të qëndrueshmërisë (stabilitetit) të furnizimit.*

Të dhëna do të grumbullohen nga OST (për energjinë elektrike), respektivisht nga OSSH (për energjinë termike). Kërkesat përkatëse parashtrohen në formë të pyetësorëve për palë të ndryshme.

5.1 Bilancet e energjisë elektrike

Bilanci vjetor i energjisë elektrike duhet të përmbajë të dhënat e parashikuara të: prodhimit, konsumit dhe ngarkesës (të secilit grup të konsumatorëve dhe kërkesës së gjithmbarshme), humbjeve të energjisë elektrike në Sistemin e Transmetimit (ST) dhe Sistemet e Shpërndarjes (SSH), si dhe importet dhe eksportet e energjisë elektrike. Përveç kësaj bilancet e energjisë elektrike duhet të përmbajnë edhe të dhëna për remontet e njësive gjeneruese, emetimet e gazrave, eficiencën e energjisë, remontet e linjave dhe transformatorëve të rrjetit të transmetimit si dhe për investimet kryesore në rrjet.

Bilanci afatgjatë i energjisë elektrike duhet të përfshijë: përshkrimin e sektorit të energjisë elektrike, metodologjinë për parashikimin e kërkesës, (planifikimin e konsumit dhe ngarkesës të së secilit grup të konsumatorëve dhe atë të gjithmbarshme për skenarë të ndryshëm, parashikimin e masave eficiente që ndikojnë në kursimin e energjisë, parashikimin e zhvillimit të alternativave tjera që ndikojnë në uljen e konsumit të energjisë elektrike, parashikimin e importit dhe eksportit) pasqyrën e situatës së kaluar dhe të tanishme të Sistemit Elektro Energjetik (SEE), skenarët e gjenerimit dhe kërkesës bazuar në Bruto Produktin Vendor (BPV), si dhe besueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit.

5.2 Bilancet e energjisë termike

Bilanci Vjetor i Energjisë Termike do të përmbajë: të dhënat për prodhimin, parashikimin e kërkesës (konsumit) së konsumatorëve ekzistues dhe potencial, konsumin vetanak të impianteve për prodhimin e energjisë termike, llojin e lëndës djegëse dhe konsumin e lëndës djegëse për secilën njësi, të dhëna për kapacitetin e instaluar dhe operativ [në MW], riparimet e njësive gjeneruese, emetimet e gazrave, efikasitetin termik të njësive / kaldajave [në %], eficiencën e energjisë, riparimet e sistemit (gypave dhe nënstacioneve) si dhe investimet kryesore në rrjet.

Bilanci afatgjatë i energjisë termike përfshinë një analizë të 3 viteve paraqite të të dhënave historike, si dhe planifikimet për 10 vitet e ardhshme, parashikimin e kërkesës, zgjerimit të rrjetit, vizionin dhe planet për zhvillimin e sistemit të energjisë termike etj. Këto të dhëna do të merren nga Bilancet e Energjisë Termike për vitet paraqite.

6 PYETËSORËT

Për përgatitjen e Bilancit Vjetor dhe Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Termike, duhet të dizajnohen modele të formularëve të cilët ju dërgohen palëve për plotësim. Të dhënat grumbullohen nga palët në afate të caktuara në Metodologjinë për përgatitjen e bilanceve të energjisë.

Palët përgjegjëse për ofrimin e të dhënave të kërkuara në pyetësor janë:

- Kompanitë e gjenerimit;
- OST (nga të dhënat e veta);
- OSSH-të;
- Furnizuesit;
- Konsumatorët e kyçur në nivelin 110 kV e më lartë (për energji elektrike);

Forma të pyetësorëve për grumbullimin e dhënave për përgatitje të bilanceve të energjisë janë dhënë në Shtojca.

Në tabelat e mëposhtme janë listuar disa nga llojet e të dhënave që do të kërkohen, si dhe palët përgjegjëse për sigurimin e tyre.

Tabela 1 - Të dhënat dhe palët përgjegjëse për Bilancin e Energjisë Elektrike

Të dhënat	Pala përgjegjëse / sqarime
Disponueshmëria dhe kapacitetet e gjeneratorëve (faktori i ngarkesës)	Kompanitë e Gjenerimit
Prodhimi bruto dhe neto i energjisë (sipas lëndës djegëse)	Kompanitë e Gjenerimit
Humbjet në transmetim dhe shpërndarje	OST dhe OSSH
Gjendja e deponisë – rezervat e lëndëve djegëse	Kompanitë e gjenerimit me lëndë djegëse fosile duhet të japin informata mbi stokun e thëngjillit (linjtit) në depozitë
Indikatorët e efijencës së energjisë	Kompanitë e Gjenerimit
Karakteristikat e rrjetit (gjatësia e linjave, niveli i tensionit, linjat e reja dhe të planifikuara të transmetimit dhe shpërndarjes)	OST/OSSH -Plani Zhvillimor i Transmetimit (PZHT) dhe Plani Zhvillimor i OSSH-së
Kërkesa e energjisë dhe trendet e furnizimit në 3 vitet paraprake, sipas burimit të energjisë	OST - këto të dhëna do të merren nga realizimet në vitet përkatëse
Analiza e indikatorëve kryesor ekonomik (BPV, konsumi për kokë banori, etj.)	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Analiza e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit të energjisë elektrike	OST



Analiza e kualitetit dhe vazhdimësisë së shërbimit	OST do të ofrojë informata mbi kualitetin e furnizimit me energji, energjinë e pa furnizuar dhe performancën e tensionit në sistem
Emetimi i ndotësve (SO ₂ , NO _x , CO ₂ , pluhur, hi)	Kompanitë e gjenerimit me lëndë djegëse fosile duhet të ofrojnë parashikime specifike të emetimit (sasia e emetimit për njësi të energjisë elektrike të prodhuar) për secilin ndotës ndaras. Këto të dhëna do të ofrohen ndaras për secilën njësi të gjenerimit.
Rekomandimet mbi masat që duhet ndërmarë për të siguruar furnizimin dhe për të minimizuar koston për konsumatorët fundor	OST (dhe OSSH sipas rastit) do të ofrojë informata mbi përforcimet me kosto-efektive në rrjetin e transmetimit (shpërndarjes), të cilat janë të domosdoshme për të mbajtur furnizimin e sigurt të energjisë elektrike.
Kapacitetet rezervë të energjisë elektrike për të arritur nivelet e kërkuara të sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit.	OST dhe kompanitë e gjenerimit

OST do tu drejtohet furnizuesve të licencuar dhe konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 110 kV e më lartë me kërkesë për të marrë të dhënat për përgatitjen e bilanceve të energjisë. Për të gjithë konsumatorët tjerë, kërkesa për të dhënat i drejtohet OSSH-së apo Furnizuesit të Licencuar përkatës. Gjithashtu, OST do tu drejtohet edhe gjeneratorëve për ofrimin e të dhënave sipas formateve të paraqitura në shtojcë.

Tabela 2 - Të dhënat dhe palët përgjegjëse për Bilancin e Energjisë termike

Të dhënat	Pala përgjegjëse dhe sqarime
Kapacitetet e Prodhimit të Energjisë termike dhe Disponueshmëria (faktori i ngarkesës)	Ndërmarrjet e prodhimit të energjisë termike përfshirë edhe kogjenerimin
Prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike (sipas lëndës djegëse)	Ndërmarrjet e prodhimit të energjisë termike përfshirë edhe kogjenerimin
Rezervat e lëndëve djegëse të depozituara	Ndërmarrjet e prodhimit të energjisë termike përfshirë edhe kogjenerimin duhet dhënë informata mbi stokun e lëndëve djegëse fosile
Indikatorët e efikasitetit të energjisë, të impianteve të prodhimit të energjisë termike	Ndërmarrjet e prodhimit të energjisë termike përfshirë edhe kogjenerimin.
Humbjet në rrjetin e transportimit të energjisë termike (nëse është e	OSSH

aplikueshme) dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes	
Karakteristikat e rrjetit (gjatësia e tubacioneve, tubacionet e reja të planifikuara të transportimit dhe shpërndarjes së energjisë termike)	OSSH (Plani Zhvillimor i OSSH)
Kërkesa për energji termike dhe trendet e furnizimit në 3 vitet paraprake	Furnizuesit - Këto të dhëna do të merren nga realizimet në vitet përkatëse.
Analiza e indikatorëve kryesor ekonomik (BPV, popullata, konsumi për kokë banori, etj.)	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Analiza e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit të energjisë termike	Ndërmarrja e energjisë termike - Furnizuesi
Analiza e kualitetit dhe vazhdimësisë së shërbimit	Ndërmarrja e energjisë termike - Furnizuesi do të ofrojë informata mbi energjinë termike të pa furnizuar dhe performancën e indikatorëve kryesorë të sistemit: presionit dhe temperaturës.
Emetimi i ndotësve (SO ₂ , NO _x , CO ₂ , pluhur, hi)	Ndërmarrjet e gjenerimit me lëndë djegëse fosile duhet të ofrojnë parashikime specifike të emetimit (sasia e emetimit për njësi të energjisë termike të prodhuar) për secilin ndotës ndaras. Këto të dhëna do të ofrohen ndaras për secilën njësi të gjenerimit.
Rekomandimet mbi masat që duhet ndërmarrë për të siguruar furnizimin dhe për të minimizuar koston për konsumatorët fundor	OSSH do të ofrojë informata mbi përforsimet me kosto-efektive në rrjetin e transportimit dhe shpërndarjes, të cilat janë të domosdoshme për të mbajtur furnizimin e sigurt të energjisë termike.
Burimet e furnizimit me lëndë djegëse, dhe kapacitetet rezervë të energjisë termike për të arritur nivelet e kërkuara të sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit	Ndërmarrjet e prodhimit të energjisë termike përfshirë edhe kogjenerimi.

OST (për energjinë elektrike) dhe OSSH (për energjinë termike) duhet të fillojnë aktivitetet për përgatitjen e bilanceve me 15 qershor të çdo viti për bilancet vjetore dhe çdo dy vite për bilancet afatgjate. Draftet fillestare përgatiten në shtator dhe pas marrjes së mendimit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (Ministria), dërgohet në ZRRE për miratim.

ZRRE analizon dokumentin, dhe në rast nevojë kërkon të dhëna apo sqarime shtesë, dhe bënë aprovimin e tij më së largu deri me 15 dhjetor të vitit aktual, për periudhën të cilën parashikuese.



KREU II - METODOLOGJIA PËR PËRGATITJEN E BILANCEVE TË ENERGJISË

Metodologjia për përgatitjen e bilanceve të energjisë elektrike dhe termike për periudhat njëvjeçare dhe afatgjata (dhjetë vjeçare) përshkruan mënyrën e përgatitjes së bilanceve, të dhënat e nevojshme, përgjegjësit për ofrimin e të dhënave dhe afatet kohore. Të dhënat për bilancin vjetor trajtohen në baza mujore, ndërsa për bilancin afatgjatë në baza vjetore.

Bilancet e energjisë duhet të përfshijnë shpjegimin e mënyrës së llogaritjes së parashikimeve të: prodhimit të energjisë, parametrat (inputet) e përdorur në kalkulimin e ngarkesës dhe konsumit të secilit grup të konsumatorëve dhe asaj të gjithmbarshme, humbjeve të energjisë për OST dhe OSSH, importet dhe eksportet e energjisë, etj. si dhe përshkrimin e metodologjisë (qasjes) për përpilimin e bilancit të energjisë.

Gjatë parashikimit të bilancit të energjisë mund të përdoret qasja (metoda) nga poshtë-lartë apo larë-poshtë, por pavarësisht qasjes së përdorur prodhimi dhe konsumi i energjisë duhet të jenë të balancuar në baza mujore dhe vjetore.

Metoda lartë - poshtë

Në këtë metodë gjeneratorët parashikojnë prodhimin e tyre pavarësisht kërkesës që mund të rezultojë për konsum. Pastaj diferenca apo mungesa e energjisë elektrike, ndërmjet prodhimit dhe konsumit mund të rezultojë me import apo eksport shtesë. Kjo metodë mund të rezultojë me sasi më të lartë të importit, ngase gjeneratorët mund të planifikojnë revizione apo remonte që nuk janë të harmonizuara me planin e konsumit.

Metoda poshtë - lartë

Gjatë përdorimit të metodës poshtë-lartë së pari bëhet parashikimi i kërkesës dhe më-pastaj shihen opsionet e mbulimit të kërkesës nga gjenerimi vendor dhe importi. Parashikimi i kërkesës për energji mund të ndahet: parashikimin e kërkesës së energjisë elektrike në nivel të rrjetit të shpërndarjes dhe parashikimin e kërkesës për energji në rrjetin e transmetimit.

Duke pasur parasysh prodhimin jofleksibil të gjeneratorëve dhe konsumin që ndryshon në baza ditore dhe mujore, atëherë qasja më e përshtatshme do të ishte kombinimi i ketër dy metodave. Sipas kësaj plani i prodhimit të energjisë elektrike nga gjeneratorët duhet të harmonizohet me planin e konsumit të energjisë elektrike, në mënyrë që nevoja për import të jetë sa më e vogël. Qëllim i kësaj metode është që prodhimi, respektivisht konsumi me qenë i racionalizuar si kosto dhe sasi e prodhimit dhe konsumit.

7 PËRGATITJA E BILANCEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Parashikimi i kërkesës për energji elektrike

Kërkesa për energji elektrike përcakton konsumin e planifikuar në MWh apo GWh. Bilancet e energjisë elektrike do të përmbajnë parashikimin e kërkesës (GWh), ngarkesën maksimale dhe minimale (MW), humbjet në transmetim (OST) dhe humbjet në shpërndarje (OSSH) të cilat parashikohen ndaras dhe do t'iu shtohen parashikimeve të kërkesës; tepricat/mungesat që do të kalkuloohen si ndryshim në mes kërkesës së parashikuar të energjisë elektrike dhe energjisë elektrike në dispozicion nga gjenerimi.

Të gjitha parashikimet e kërkesës duhet të bazohen në realizimin e kërkesave në të kaluarën, pritjet për rritjen e numrit të konsumatorëve, ndikimet e tarifave në konsum, zhvillimin ekonomik dhe alternativat e zëvendësimit të energjisë elektrike nga burimet tjera. Planifikimi i konsumit duhet të marr parasysh edhe BPV për periudhën e parashikimit të bilancit, ndryshimet e temperaturës dhe kyçjet/shkyçjet e ngarkesave. Planifikimi i konsumit gjithashtu duhet të përshtatet edhe me ndryshimet e njohura specifike (p.sh. ngarkesat e mëdha të supozuara, apo parashikimi i ndryshimeve në operimin e konsumatorëve të kyçur në nivelin 110 kV e më lartë).

Shpenzimet vetanake në termocentrale

Termocentralet me lëndë djegëse fosile kërkojnë të furnizohen me energji elektrike për të vënë në funksion sistemet ndihmëse të termocentralit si dhe kërkesat e stabilimenteve ndihmëse (p.sh. minierat gjegjëse). Në këtë pjesë përshkruhet se si do të përlllogaritet kërkesa vetanake për energji elektrike në termocentrale, meqenëse është i nevojshëm përcaktimi i saktë i energjisë së përdorur për shpenzime vetanake.

Figura 1 paraqet në mënyrë skematike termocentralet Kosova A dhe Kosova B, dhe mënyrën e furnizimit vetanak me energji elektrike. Termocentralet potenciale që pritet të ndërtohen në të ardhmen do të kenë dizajne të ngjashme. Në figurë gjithashtu paraqitet kërkesa në sistemin e transmetimit, që do të thotë: kërkesa e OSSH-së dhe konsumatorëve në nivelin 110 kV e më lartë.




Figura 1 Skema e rrjedhave të energjisë elektrike në termocentralet e Kosovës

Sa i përket rrjedhave të energjisë në termocentral dhe nga termocentrali, mund të identifikojmë katër rrjedha të energjisë:

- Rrjedha e energjisë (1) - Energjia bruto e prodhuar nga gjeneratorët M1, M6, M10, M13 dhe M16
- Rrjedha e energjisë (2) - Energjia e shfrytëzuar për shpenzimet vetanake që ofrohet drejtpërdrejt nga gjeneratori (vetëkonsumi) përmes transformatorit të njësisë. Kjo energji rrjedh përmes transformatorit për shpenzime vetanake të njësisë (M2 dhe M7 për TCB ndërsa M11, M14 dhe M17 për TCA), dhe kjo energji nuk vërehet fare nga Sistemi i Transmetimit. Kur njësisia gjeneruese nuk gjeneron, do të veprojë si ngarkesë në sistemin e transmetimit dhe do të shihet si import i vogël në termocentral.
- Rrjedha e energjisë (3) - Energjia e marrë apo e dhënë nga Sistemi i Transmetimit përmes transformatorit të gjeneratorit është e barabartë me energjinë e matur nga njehsorët M3 dhe M8 (eksport) apo M4 dhe M9 (import).
- Rrjedha e energjisë (4) - Energjia e shfrytëzuar nga furnizimi ndihmës dhe pajisjet tjera të cilat furnizohen drejtpërdrejt nga Sistemi i Transmetimit. Kjo energji matet me njehsorët M5 dhe M19 deri M22.

Për përpilimin e Bilanceve të Energjisë elektrike përdoren të katër llojet e rrjedhave të energjisë.

7.1 Bilanci vjetor i energjisë elektrike

7.1.1 Përmbajtja e Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike

Përmbajtja dhe të dhënat që kërkohen për përpilimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike janë të listuara më poshtë. Sqarimet për pikat në vijim janë dhënë me shkronja *italike*.

- Hyrje.
- Pasqyrë e bilancit vjetor të energjisë elektrike.
- Kriteret e hartimit të bilancit vjetor të energjisë elektrike.
- Kapacitetet instaluese për prodhim të energjisë elektrike - *Duhet të trajtohen ndaras për secilin central, sipas llojit të burimit primar të energjisë.*
- Plani i prodhimit të energjisë elektrike - *Duhet të trajtohet ndaras për secilin central pavarësisht llojin e burimit primar të energjisë, kapacitetin apo sistemin ku kyçet në rrjetë. Për secilën njësi gjeneruese të çdo centrali, raporti do të përmbajë energjinë mujore të parashikuar për prodhim, energjinë që do shfrytëzohet për vetëkonsum (nëse ka). Energjia për vetëkonsum do të ndahet në energjinë e ofruar nga gjeneratorët përmes bllok transformatorëve dhe energjinë e furnizuar nga sistemi i transmetimit. Dokumentet e parashtruara do të marrin parasysh shkyçjet e planifikuara të njësisve gjeneruese.*
- Burimet e Ripërtrishme të Energjisë (BRE) - *Duhet të trajtohen ndaras sipas llojit të burimit primar të energjisë.*
- Plani i prodhimit të gjithmbarshëm të energjisë elektrike - *Tabelë përmbledhëse që mbulon tërë gjenerimin.*
- Planifikimi i importit dhe eksportit të energjisë elektrike - *Në bilancin vjetor importi duhet të paraqitet veçmas për kategori të ndryshme (konsumatorët e shërbimit universal, konsumatorët e parregulluar, humbjet në sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes si dhe importi për mbulimin e shërbimeve ndihmëse). Po ashtu në bilanc duhet të paraqitet edhe eksporti kur sistemi ka teprica të energjisë elektrike.*
- Plani i konsumit të energjisë elektrike - *Përfshinë kërkesën mujore të energjisë për konsumatorët e kyçur në transmetim, konsumatorët e kyçur në sistemin e shpërndarjes, të ndarë sipas furnizimit në nivelet e tensionit (35kV, 10 kV, 0.4 kV).*
- Humbjet e energjisë elektrike - *Humbjet në transmetim dhe humbjet në shpërndarje të ndara në humbjet teknike dhe humbjet komerciale gjegjësisht konsumi i paautorizuar i energjisë elektrike (varësisht nga kërkesa e ZRRE-së të ndara edhe në kategori tjera).*
- Plani i ngarkesave maksimale (pikut) dhe minimale të sistemit - *Paraqet kërkesën maksimale mujore (MW) të sistemit, për konsumatorë të mëdhenj, për shpërndarjen, si dhe kërkesën minimale për tërë sistemin.*
- Shërbimet ndihmëse – *Në kuadër të shërbimeve ndihmëse do të paraqiten: rezerva primare (frekuencë-fuqi), rezerva sekondare dhe rezerva terciare të parashikuara për çdo muaj.*
- Saldo e bilancit vjetor të energjisë elektrike për vitin aktual - *Paraqet bilancin mujor të energjisë, në baza mujore duke përfshirë: Prodhimin sipas gjeneratorëve, importin sipas kategorive (për*

konsumator të rregulluar, parregulluar, humbjet në OST dhe OSSH), konsumin në shpërndarje dhe në transmetim (konsumatorët e mëdhenj, mihjet, shpenzimet vetanake e gjeneratorëve), humbjet në transmetim dhe humbjet në shpërndarje – teknike dhe komerciale (varësisht nga kërkesa e ZRRE-së të ndara edhe në kategori tjera), dhe eksporti që paraqet tepricat e energjisë duke bërë barazimin e saldos së sistemit. Me poshtë në këtë dokument është përshkruar mënyra e kalkulimit të komponentëve të saldos së bilancit.

- Dinamika e prodhimit dhe konsumit të qymyrit me gjendje në depo – *Paraqet parashikimet mujore të prodhimit të linjtit, konsumit dhe lëvizjeve në deponi.*
- Planifikimi i remonteve dhe revizioneve të kapaciteteve prodhuese – *Paraqet parashikimin e remonteve përfshirë ndryshimet e mundshme në kapacitete në të ardhmen (ngritje apo zbritje) për shkak të riparimeve apo arsyeve tjera, të cilat duhet të jepen për çdo central, qoftë me lëndë djegëse fosile, me burime ujore apo të tjera të ripërtitshme.*
- Emetimi i ndotësve të ajrit për termocentrale për secilën njësi që prodhon energji me djegie karburantesh fosil - *duhet të kalkulojen emetimet e parashikuara të SO₂, NO_x dhe CO₂ nga vetë kompania gjeneruese, në bazë të sasisë së energjisë që parashihet të gjenerohet dhe koeficientit specifik të emetimit (d.m.th. sasia e emetimit për njësi të energjisë së prodhuar).*
- Indikatorët e efijencës së termocentraleve – *Duhet të paraqitet kalkulimi i efikasitetit termal të të gjitha termocentraleve me lëndë djegëse fosile.*
- Remontet, revizionet dhe mirëmbajtja e kapaciteteve transmetuese (linjave) dhe transformuese (transformatorëve) dhe pajisjeve të tensionit të lartë në nënstacione - *Këtu paraqitet teksti që jep informata mbi tabelën që përshkruan remontet. Plani i remonteve në transmetim përfshinë edhe linjat interkonektive me OST-të tjera dhe transformatorët 400/220, 400/110 dhe 220/110 kV të cilat harmonizohen me OST-të e vendeve fqinjë. Për secilën shkyçje duhet paraqitur data fillestare dhe kohëzgjatja e supozuar e shkyçjes.*
- Projektet e parapara për vitin vijues – *Paraqet përmbledhje të projekteve të transmetimit që pritet të realizohen gjatë vitit vijues.*

7.1.2 Saldo e bilancit të energjisë

Saldo e bilancit të energjisë përmban të gjitha rrjedhat e energjisë si në nivel të transmetimit po ashtu edhe atë të shpërndarjes. Në rastin e bilancit vjetor të energjisë, saldoja duhet të paraqesë rrjedhat mujore.

Afatet kohore për hartimin e Balanceve të Energjisë Elektrike dhe Energjisë Termike janë përmbledhur në formë diagrami në Shtojcat e rregullës për përgatitjen e balanceve të energjisë.

- Prodhimi nacional neto (PNn)

$$PNn = GnTC + Gt + Gsh$$

Ku:

G_{nTC} – Gjenerimi neto i energjisë elektrike nga termocentralet

G_t - Gjenerimi i energjisë elektrike nga gjeneratorët tjerë të kyçur në rrjetin e transmetimit

G_{sh} – Gjenerimi i energjisë elektrike nga gjeneratorët e kyçur në rrjetin e shpërndarjes

Prodhimi nacional neto përmban prodhimin e gjeneratorëve duke ja zbritur shpenzimet vetanake nga skemat e brendshme dhe nga transmetimi.

Prodhimi nga termocentralet duhet të paraqitet duke i trajtuar veçmas shpenzimet vetanake të gjeneratorëve (nga skemat e brendshme dhe nga sistemi i transmetimit).

$$G_nTC = G_bTC - Sh_{vb} - Sh_{vt}$$

Ku:

G_nTC – Gjenerimi neto i energjisë elektrike nga termocentralet

G_bTC – Gjenerimi bruto i energjisë elektrike nga termocentralet

Sh_{vb} – Shpenzimet vetanake të termocentraleve nga skemat e brendshme

Sh_{vt} – Shpenzimet vetanake të termocentraleve nga transmetimi

- Energjia elektrike në hyrje të transmetimit (EhT)

Energjia elektrike në hyrje të transmetimit paraqet tërë energjinë e cila e ngarkon rrjetin e transmetimit, ku përfshin: prodhimin neto të futur në transmetim, energjinë për shpenzime vetanake që merret nga transmetimi dhe energjinë nga importi.

$$Eht = PNn - Gsh + Shvt + Imp$$

- Importi (Imp)

Importi është energjia elektrike për plotësimin e diferencës në mes të prodhimit dhe kërkesës (kur prodhimi nuk e mbulon plotësisht kërkesën). Importi duhet të paraqitet veçmas për konsumatorët me të drejtë të shërbimit universal, konsumatorë e parregulluar si dhe për mbulimin e humbjeve (të transmetimit dhe shpërndarjes), dhe si total i përbashkët.

$$Imp = KS - PNn$$

Ku:

KS – Kërkesa e përgjithshme e sistemit

- Energjia në disponim (ED)

Kjo sasi e energjisë gjendet duke i mbledhur prodhimin nacional dhe importin:

$$ED = PNn + Imp$$

- Kërkesa e përgjithshme e sistemit energjetik (KS)

Parashikimi i kërkesës së përgjithshme të sistemit për energji elektrike përbëhet nga kërkesa në shpërndarje dhe kërkesa në transmetim.

$$KS = Kkt + KM + Ksh + H_t$$

Ku:

KS – kërkesa e gjithmbarshme për energji elektrike në sistem në GWh apo MWh;

Kkt – kërkesa e konsumatorëve të kyçur në rrjetin e transmetimit;

KM – konsumi i mihjeve;

K_{sh} –kërkesa për energji elektrike në rrjetin e shpërndarjes;

H_t – humbjet në nivelin e transmetimit në GWh apo MWh.

- Kërkesa në rrjetin e transmetimit (K_t)

Paraqet energjinë e konsumatorëve të kyçur në rrjetin e transmetimit duke përfshirë konsumin e mihjeve si dhe humbjet në transmetim.

$$K_t = KK_t + KM + H_t$$

- Kërkesa në rrjetin e shpërndarjes (K_{sh})

Kërkesa në rrjetin e shpërndarjes bëhet duke marr parasyshë kërkesën e kategorive të konsumatorëve të kyçur në rrjetin e shpërndarjes (35kV, 10kV dhe 0.4kV) dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Kërkesa e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes llogaritet sipas formulës në vijim:

$$K_{sh} = KK_{sh} + H_{teksh} + H_{komsh} + H_{tejsh}$$

Ku:

K_{sh} -kërkesa e gjithëmbarshme për energji elektrike në rrjetin e shpërndarjes në GWh apo MWh

KK_{sh} – kërkesa e konsumatorëve të kyçur në rrjetin e shpërndarjes

H_{teksh} - humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes

H_{komsh} - humbjet komerciale në rrjetin e shpërndarjes

H_{tejsh} – Humbjet e tejkaluara eventuale në rrjetin e shpërndarjes (paraqiten si ndryshim në mes të humbjeve që priten të realizohen dhe humbjeve të lejuara nga ZRRE)

- Kërkesa e rrjetit të shpërndarjes nga rrjeti i transmetimit (K_{sht})

$$K_{sht} = K_{sh} - G_{jsh}$$

Ku:

G_{jsh} – Prodhimi nga gjenerimi në shpërndarje

- Humbjet në rrjet

Saldoja e bilancit duhet të përmbaj edhe humbjet në transmetim (të lejuara dhe të tejkaluara), dhe humbjet në shpërndarje, të cilat duhet të trajtohen veçmas.

- Eksporti (Exp)

Eksporti është energjia elektrike që paraqet diferencën në mes të prodhimit dhe kërkesës (kur prodhimi është më i madh se kërkesa). Gjithashtu eksporti shërben për barazimin e saldës së bilancit.

$$Exp = PN_n - KS$$

- Barazimi i Saldos (S)

$$S = PN_n - KS + Imp - Eks = 0$$

7.1.3 Afatet kohore të bilancit vjetor të energjisë elektrike

Në bazë të Ligjit për Energjinë kërkohet nga ZRRE që të miratoj dhe publikojë Bilancin Vjetorë të Energjisë, më së voni deri më pesëmbëdhjetë (15) dhjetor të vitit aktual që i paraprinë periudhës vijuese.

OST duhet të dorëzojë Bilancin Vjetorë të Energjisë Elektrike në ZRRE pas marrjes së mendimit nga Ministria. Afatet kohore në vijim janë në pajtueshmëri me Ligjin për Energjinë, dhe paraqesin orare obligative për hartimin e bilancit:

- Deri më 15 qershor të secilit vit, ZRRE-ja nëpërmjet shkresës zyrtare do të kërkojë përfshirjen e të dhënave të caktuara në parashikimin vjetor. Nëse deri më 15 qershor nuk paraqitet asnjë kërkesë, atëherë OST do të supozojë se formati do të jetë identik me atë të vitit të kaluar.
- Deri më 1 korrik, OST do të parashtrijë pyetësorët për të marrë të dhëna, nga kompanitë e gjenerimit, OSSH, Furnizuesit dhe palët tjera. Konsumatorëve që furnizohen në nivelin 110kV dhe më lartë, do t'u kërkohet që të ofrojnë informata për parashikimin e konsumit të tyre. Mostrat e këtyre pyetësorëve janë dhënë në Shtojcën C të kësaj Rregulle.
- Pyetësorët e plotësuar nga palët duhet të kthehen deri më 31 korrik.
- Mes datave 01 gusht dhe 10 shtator, OST do të përgatisë draftin e Bilancit Vjetorë të Energjisë Elektrike. Gjatë kësaj periudhe OST mund të ketë pyetje shtesë lidhur me të dhënat të cilat janë dorëzuar nga palët. Vërejtje të tilla mund të parashtrihen në rast të dy-kuptimësive, mosmarrëveshjeve, gabimeve të mundshme, etj. Nëse OST identifikon ndonjë vërejtje, atë do ta diskutojë me palën që i ka ofruar të dhënat në fjalë.
- Deri më 10 shtator OST do të dërgoj draftin fillestar të Bilancit Vjetorë të Energjisë Elektrike për konsultime. Ky dokument duhet t'i dorëzohet Ministrisë për komentim, ku ministria duhet ti kthej OST-së komentet eventuale në një afat prej 20 ditë kalendarike nga dita e dërgimit.
- Deri më 05 tetor, OST do të përfshinë komentet e Ministrisë dhe e dërgon dokumentin në ZRRE për shqyrtim dhe miratim.
- Deri më 25 tetor ZRRE analizon dhe dërgon komentet e para të bilancit në OST. Nëse dokumenti pëson ndryshime esenciale (sipas vlerësimit të ZRRE ose KOSTT) nga të dhënat fillestare të dërguara nga palët, atëherë të dhënat përkatëse sipas përgjegjësive ju dërgohen edhe njëherë palëve për komentim, me afat përgjigjeje prej 5 ditë kalendarike nga data e dërgimit (palët tjera në raport me KOSTT). Nëse brenda kësaj periudhe nuk ka ndonjë koment, atëherë konsiderohet se palët nuk kanë vërejtje. Përgjigjet e OST në komentet e ZRRE, që nuk afektojnë esencialisht palët duhet të bëhen brenda 5 ditëve pune.
- Dokumenti final për aprovim pas përfshirjes së të gjitha komenteve duhet të dërgohet në ZRRE më së largu deri më 30 nëntor.
- Më së largu deri më 15 dhjetor të vitit aktual që i paraprinë periudhës vijuese, rregullatori miraton bilancin, dhe e unifikon atë në një dokument të përbashkët me bilancin e energjisë termike, të cilin e publikon në faqen elektronike zyrtare.

Palët obligohen që së bashku me pyetësorët, në formatin eksel, të dërgojnë edhe kalkulimet e të gjitha të dhënave orë për orë (të përmbledhura), në mënyrë që të argumentohet arsyeshmëria e vlerave të paraqitura në dokument, dhe si të tilla së bashku me kalkulimet e veta OST ti dërgoj në ZRRE me dokumentin e bilancit.

